




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASENIT LUMOR SHKUMBIN

VENDIM

Nr.9, datë 26.05.2026



PËR

MIRATIMIN E LEJES PËR NXJERRJE DHE SHFRYTËZIM TË UJIT
NËNTOKËSOR NËPËRMJET SHPIMIT PËR QËLLIME TË
NDRYSHME, TË SUBJEKTIT "GRIMER" SH.P.K, ME
VENDNDODHJE: NJ. ADM BRADASHESH, BASHKIA ELBASAN.

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, "Për Burimet Ujore", i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.319, datë 11.06.2025, "Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Shkumbin,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje për nxjerrje dhe shfrytëzim të ujit nëntokësor nëpërmjet shpimit për qëllime të ndryshme, të subjektit "Grimer" sh.p.k, me vendndodhje: Nj. Adm Bradashesh, Bashkia Elbasan.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujor (**pus-shpimi**):

- X= 502361.17
- Y= 4550233.15
- Z= 87.2 m
- Sasia e ujit që jepet në përdorim : Q= 1.2 l/sek

- Qëllimi i përdorimit të ujit: Për qëllime të ndryshme (sanitare, MNZ)

- Thellësia e pus-shpimit: 61 m

- Thellësia e vendosjes së pompës : 46 m

- Koordinatat e pikës së shkarkimit:

X= 502348.67;

Y= 4550189.01;

Z= 86.5 m

- Prurja që shkarkohet: Q= 0.0231 l/sek

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBL SHKUMBIN

ILIR BEJTJA

